

VENDIM
Nr. 59, datë 20.7.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM
TARIFE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 7.20.2018, pasi shqyrtoi relacionin mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër, përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike,

konstatoi se:

ERRU-ja, në përmbushje të përgjegjësiave ligjore, konkretisht: neni 14, neni 22 dhe neni 33, i ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, miraton tarifat e shërbimeve ujësjiellës-kanalizime, në mënyrë që të sigurojë konsumatorët që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht;

Bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër”, pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale;

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 983 prot., datë 27.6.2018, me lëndë: “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani